



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 748 Prot

Vlorë 28 . 3 .2018

VENDIM

Nr. 7 , datë 21/03 /2018

**PËR PËRDITËSIMIN E RREGULLORES MBI “KOMPETENCAT DHE
DETYRAT E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORE”
MIRATUAR ME VKQ NR.5, DATË 04.03.2016**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur më datën e sipërpërmendur në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”, ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit Nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, VKM Nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, VKM nr. 142 dt.12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore si dhe institucionet e pavarura”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr.30, datë 20.12.2017 “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2018” si dhe të Rregullores mbi “Kompetencat dhe detyrat e Administratës së Këshillit të Qarkut”, miratuar me VKQ Nr.5, datë 04.03.2016,

VENDOSI;

1. Të miratoj përditësimin e Rregullores “Kompetencat dhe detyrat e Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë” miratuar me VKQ Nr.5, datë 04.03.2016, për vitin 2018 si dhe anekset e saj në funksion të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr.30, datë 20.12.2017 “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2018”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit të Qarkut, si dhe drejtoritë përbërëse të administratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”, datë 17.12.2015 neni 78.

KRYETAR

Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. _____ Prot, datë _____ .2018

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600